

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Superintendent

4 Mars, 2022

Të Dashur Familje dhe Studentë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Këto dy vitet e fundit kanë qenë jashtëzakonisht të vështira; duke vështirësuar qëndrueshmërinë dhe humanizmin tonë. Dhe së fundmi, ne jemi thellësisht të shqetësuar nga sulmet në rritje në Ukrainë, dhe imazhet tronditëse që dëshmojnë për humbjen tragjike të jetës dhe shkatërrimin që intensifikohet çdo ditë.

Komuniteti ynë i Drejtorisë Arsimore pasqyron një gamë të gjerë racash, kulturash dhe prejardhjesh. Si organizatë, ne shprehim shqetësimin, simpatinë dhe mbështetjen tonë më të thellë për personelin, studentët dhe familjet tona që kanë lidhje me Ukrainën – shumë prej të cilëve po përjetojnë trishtim dhe shqetësim të thellë për të dashurit e tyre. Ju lutemi dijeni se ne jemi këtu për t'ju mbështetur.

Ekipet e këshillimit në secilën prej shkollave tona janë në dispozicion për studentët dhe personelin që kanë nevojë për mbështetje. Ju lutemi mos hezitoni të kontaktoni shkollën tuaj për ndihmë. Për më tepër, Zyra e “Diversity”, Barazisë dhe Përfshirjes është e disponueshme për të mbajtur hapësira për biseda në komunitet ndërsa ne të gjithë kalojmë këtë kohë të vështirë. Ju lutemi dërgoni email equity@philasd.org për më shumë informacione. Ne u kemi dhënë gjithashtu këshilltarëve tanë dhe drejtuesve të shkollave burime për t'i ndihmuar dhe mbështetur studentët gjatë kësaj kohe. Burimet e dobishme për familjet janë të disponueshme më poshtë:

- [Burime për edukatorët, familjet për të diskutuar ngjarjet në Ukrainë me studentët.](#)
- [Si të bisedoni me të rinjtë për Ukrainën](#)
- [Si duhen ndihmuar studentët të përballen me një botë të dhunshme](#)
- [Shoqatës Psikologjike Amerikane.](#)
- [Artikulli i Shoqatës Psikologjike Amerikane: Qëndrueshmëria në një kohë lufte: Këshilla për prindërit dhe mësuesit e fëmijëve të shkollave të mesme.](#)

Kjo është një situatë e pasigurtë dhe ndërkohë që ne nuk e dimë rezultatin përfundimtar apo edhe se si do të zhvillohen ngjarjet gjatë ditëve apo javëve në vijim, unë u bëj thirrje të gjithëve në komunitetin tonë të Drejtorisë Arsimore të qëndrojnë të përkushtuar për të promovuar një kulturë të përbashkët dashurie dhe dhembshurie. Le të jemi vigjilent ndaj njëri-tjetrit, me përqëndrim tek më të pambrojturit mes nesh, duke shfrytëzuar çdo mundësi për të kultivuar hapësira të guximshme në klasat dhe zyrat tona që njerëzit të ndajnë mendimet e tyre dhe të shprehin ndjenjat e tyre. Prioriteti ynë më i lartë është të ruajmë mjedise të sigurta, mikpritëse, mbështetëse dhe të barabarta për të gjithë studentët dhe personelin tonë.

Shpresojmë që kriza në Ukrainë dhe të gjitha të tjerat që ndikojnë në komunitetet të cilave u shërbejmë do të përfundojë së shpejti në mënyrë që paqja dhe shërimi të mund të fillojnë. Deri

atëherë, mezi pres të bashkohemi si një komunitet i bashkuar i drejtorisë arsimore për të mbështetur dhe kujdesur njëri-tjetrin.

Sinqerisht,

A handwritten signature in cursive script, reading "William R. Hite Jr.".

William R. Hite Jr., Ed.D.
Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias

(Albanian)